



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-27687/22
Kaçanik, 20.10.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **X (dhjetë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 22 nëntor 2022. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin shtatë (7) anëtarët: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Rabiye Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Qamil Stagova- DUKMM, ndërkaq nga zyrtarët: Fatlume Guri-Selimi –Zyrtare për Informim dhe Mavije Murseli- asistente e Kryesuesit të KK.

Mbledhjen e monitoroj nga OSBE- Rrezart Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, pjesëmarrës në mbledhje nga KPF janë të gjithë anëtarët, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e X (dhjetë) të rregullt të KPF-a për vitin 2022, data 22 nëntor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Strategjia për Informim dhe Komunikim 2023-2026;
3. Plani i Veprimit për Transparencë 2023-2026;
4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022;
5. Propozim Vendimi për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023;
6. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit publik të pjesëve të PK 01274-3 dhe 01274-4 në ZK Kaçanik, për këmbim me pronën komunale 01274-1 në ZK Kaçanik;
7. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit publik të pjesëve të PK 00431-3 dhe 00431-4 në ZK Duraj, për këmbim me pronën komunale 00430-1 ZK Duraj.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Meqë nga data 25 nëntor - 10 dhjetor fillon fushata globale 16 ditë aktivizim kundër dhënës në baza gjinore, në emër të subjektit politik –LVV, kërkoj që kjo çështje të hyjë në rend pune për diskutim në mbledhjen e KK të datës 30 nëntor 2022.

Kryesuesi i Kuvendit: Si e konkretizon këtë pikë me u diskutuar, të formulojmë pak me mirë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Diskutim për aktivitetet kundër dhunës në baza gjinore.

Kryesuesi i Kuvendit: Rendin e punës me 7 pikë pa propozimin e znj. Kadrije Lika-Troni e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

APROVON

Rendin e punës në përbërje prej 7 pikëve.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit, Propozimin e znj. Kadrije Lika-Troni që në mbledhje të Kuvendit të Komunës të, diskutohet për aktivitetet kundër dhunës në baza gjinore. Ky propozim u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF propozon që në mbledhje të KK të datës 30 nëntor 2022 të shtohet pika: **Diskutim për aktivitetet kundër dhunës në baza gjinore.**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua pa vërejtje, me 6 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenoj Agim Mani -për shkak se nuk ka qenë pjesë e procesit. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

APROVON

Procesverbalin e mbledhjes së IX (nëntë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të datës 20.10.2022/ Lënda: 01Nr. 60/01-27687/22.

2. Strategjia për Informim dhe Komunikim 2023-2026;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e kësaj pike e ka hartuar ekzekutivi i komunës. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Kjo strategji në përmbajtje ka një rëndësi shumë të veçantë, sepse krijon ura të komunikimit në aspektin e informimit. Zyra e Informimit funksiononin në kuadër të kabinetit të Zyrës së Kryetarit të Komunës. Shqetësuese është që kjo zyre funksionon me vetëm 1 zyrtar. A mendoni me rritur këtë numër, në mënyrë që informacionet të jenë sa më të sakta, marrë parasysh faktin se në komunën tonë nuk operon asnjë medium publik. Për me qenë komuna sa më transparente ndaj qytetarëve, është mirë me rritur numrin e zyrtarëve në Zyrën e Informimit.

znj. Kadrije Lika-Troni: Të çështja e zërimit të sallës së KK, unë kam vërejte se zërimi nuk është sa duhet i qartë. A keni bërë ndonjëherë ankesë të operatori që e mirëmban zërimin, me intervenuar në këtë drejtim apo me ndërruar zërimin, sepse është shumë i pakuptueshëm ?

Kryesuesi i Kuvendit: Ne nuk kemi operatorë që e mirëmban zërimin e KK, është Zyra e IT që merret me zërimin i cili zërim është i lidhur direkt me MAPL për transmetimin e tij. Ne kemi investuar kohëve të fundit pak sa i përket çështjes së zërimit, besoj se në këtë mbledhje do të jetë më funksional. I kemi blerë pajisjet vet, diku 4 -5 mijë euro. Operator mirëmbajtës nuk kemi, besoj se tani ka me qenë pak më mirë, mbledhjet transmetohen online në Youtube dhe Fabebook, nuk e

di sesi kanë me funksionuar se tani kemi me i provuar në këtë mbledhje pajisjet e reja. Sa i përket rritjes së numrit të zyrtarëve për informim, ne në mandatin e parë kemi kërkuar nga MAPL me na lejuar KK me pasur një zyrtar për informim, sepse shpesh herë po ngarkohet zyrtarja e ekzekutivit për informim me aktivitetet e KK, por nuk na kanë lejuar të kemi zyrtar të veçantë për informim për punë të KK, se është vështirë me i përmbledhur të gjitha aktivitetet me vetëm 1 zyrtar, se edhe limitet e tavaneve buxhetore janë të caktuar që nuk mundem me i lëvizur.

znj. Ardita Rrahmani: Në komunën e Kaçanikut nuk kemi media lokale, kjo e vështirëson edhe qasjen e personave që nuk i përdorin rrjetet sociale si websaitit dhe facebookut, etj. e që është një numër i konsiderueshëm i tyre. Cila është strategjia e juaj konkrete që me iu mundësuar qasje edhe këtyre personave në aktivitetet e komunës, se duhet me përcjellë mesazhin edhe të ata persona që nuk përdorin rrjetet sociale?

znj. Fatlume Guri-Selimi: Edhe në Strategji e kemi cekur se si komunë jemi të varfër në aspektin e informimit. Unë personalisht jam Zyrtare për informim, njëkohësisht i mbajë edhe dy pozita tjera, kërkoj falje nëse ndonjëherë nuk kam pasur mundësi me i përcjellë të gjitha aktivitetet. Në këtë strategji kemi menduar me i zgjeruar tabelat informuese fizike, dhe ato digjitale, që qytetarët që janë udhëtarë apo qytetarë të rastit, me u pajisur me informata. Si dobësi e kemi edhe mungesën e mediave lokale, ndërkaq ato nacionale jemi dëshmitarë se nuk përcjellin aktivitetet e komunave të vogla, përpos ndonjë aktiviteti me rëndësi të veçantë. Për realizimin e strategjisë ne mundemi me arritur përmes mediave rajonale që me u prezantuar aktivitetet e komunës tonë.

znj. Kadrije Lika-Troni: A ekziston në komunë ndonjë kanal informimi për qytetarët të cilët donë me bërë ndonjë ankesë për me paraqitur ndonjë rast, ndërkaq donë me mbetur anonim?

znj. Fatlume Guri-Selimi: Kërkesat dhe Ankesat regjistrohen, dhe të njëjtat i shkojnë atij që iu kanë adresuar dhe nuk mund t'i shohin zyrtarët tjerë, se nuk kemi të drejtë me përhapur kërkesat apo ankesat e tilla. Ajo që po kërkon ju, mund të realizohet përmes kutisë së ankesave, mund të adresohen kërkesat apo ankesat anonime pa iu shkruar emri fare. Me duhet cekur se edhe Ueb faqja e komunës është duke pasur shumë probleme, menaxhimi bëhet nga niveli qendror dhe këtë problem janë duke e pasur të gjitha komunat tjera, kështu që jemi munduar që përmes facebookut të bëjmë publikimin e njoftimeve për aktivitetet e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo Strategji e informimit t'i shkoj KK. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF së KPF e,

Aprovoj

Strategjinë për Informim dhe Komunikim 2023-2026. Kjo Strategji i ,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Plani i Veprimit për Transparencë 2023-2026;

Kryesuesi i Kuvendit: Besoj se në fushën e aspektit të transparencës qëndrojmë mirë, se çdo herë jemi kualifikuar si komunë transparente. E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Në faqen 8, të politikat lokale për trajtimin e fëmijëve të rrugës, a ka ndonjë kanal për pyetjen që e bëra me herët se ai fëmijë duhet me mbetur anonim për shkak të shoqërisë dhe rrethit, se unë kam vërejtur se ka fëmijë që dalin kërkojnë lëmshë ? Unë vet jam marrë me atë fëmijë, me siguri edhe edhe juve iu ka rastisur me pa fëmijët që kërkojnë lëmshë,

dhe ata fëmijë mund të krijojnë probleme në shkollë, shoqëri apo kudo tjetër. A jeni marrë me ata fëmijë, se këtu unë e pashë si politikë, a e ka këtë qëllim apo jo kjo politikë, unë nuk e di ?

Kryesuesi i Kuvendit: Plani ka të bëjë me transparencën e komunës lidhur me aktivitetet e komunës, ndërkaq çështja e cila u ngrit si shqetësim, ka të bëjë me tepër me politikat sociale të cilat i zhvillon QPS dhe organet e sigurisë, OSBE, të cilat mund t'i ngritin si probleme shqetësuese.

znj. Kadrije Lika-Troni: Në material shkruan: Politikat lokale për trajtimin e fëmijëve të rrugës. Me intereson të di, çka parasheh kjo politikë?

znj. Fatlume Guri-Selimi: Këto janë të strategjia, janë përshkruar politikat strategjike të nivelit qendror. Njëra prej tyre që lidhet me transparencën është aktivizimi i qytetarëve në debate publike me qytetarë etj. , unë i kam përshkruar të gjitha. Ju keni të drejtë, por unë i kam shpjeguar me gjerësisht politikat strategjike të nivelit qendror. Drafti na ka ardhur prej MAPL, ndërkaq ne ia kemi përshtatur komunën tonë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky plan t'i shkoj KK. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj

**Planin e Veprimit për Transparencë 2023-2026. Ky plan i veprimit i,
Rekomandohet**

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Lidhur me këtë pikë fjalën e ka DBF, Bahri Selimi:

Bahri Selimi: Vendimi është marrë në një mbledhje të mëhershme të KK -në muajin shtator dhe është vlerësuar i ligjshëm, por ka lind nevoja me u bërë ndryshime në vendim, se ka pësuar ndryshime dhe ministria me kanë rekomanduar me përsëritë vendimin. Vendimi është i datës 29.09.2022, koha nuk mjafton me i investuar këto mjete në projektin e paraparë, ata të ministrisë me kanë thënë dërgoj diku tjetër këto mjete, e kam shkresën të cilën më kanë dërguar.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Unë desha me u ndërlidhur me këtë çështje se është i njëjti kod dhe e njëjta shumë. Me intereson të di sa mjete kanë mbetur pa shpenzuar në këtë kod buxhetor të shërbimet e QPS?

Kryesuesi i Kuvendit: Për mbledhje të KK, kërkoj të kompletohet lënda, duke ia bashkangjitur edhe vendimin që shfuqizohet, sepse ai vendim është në fuqi.

z. Bahri Selimi: Kanë ngelur pa shpenzuar nga shuma 200.000€ minus 29,900 €, minus 56€ gjithsej: 170.044 €.

z. Agim Mani: Të transferet e mjeteve buxhetore të kategoria e shpenzimeve komunale të shëndetësia primare, keni propozuar të transferohen në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve nga kode të njëjta buxhetore.

z. Bahri Selimi: Mjetet buxhetore transferohen në të njëjtën drejtori- DSHMS, nga një nën program buxhetor të kësaj drejtorie në një nën program tjetër buxhetor të kësaj drejtorie.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që ky propozim vendim me ndryshimet që u potencuan (kompletim të lëndës) t'i kalohet KK për shqyrtim dhe aprovim? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimin për transferin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022. Ky propozim Vendim i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit publik të pjesëve të PK 01274-3 dhe 01274-4 në ZK Kaçanik, për këmbim me pronën komunale 01274-1 në ZK Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është prezent në mbledhje, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Këmbimi i pronave në fjalë, a ka qenë iniciativë e qytetarëve apo e komunës? Unë nuk e kam pa asnjë kërkesë të qytetarëve që kanë kërkuar këmbimin e pronës në fjalë.

Kryesuesi i Kuvendit: Ashtu qysh e di unë, sipas ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, interesin për me këmbyer pronat e bënë komuna, nëse nuk jam gabim.

z. Agim Mani: Komuna së pari e ka shtruar trotuarin, pastaj e ka iniciuar procedurën e këmbimit të pronave. Me intereson të di, qysh është kjo pronë në fletë poseduese ?

z. Qamil Stagova: Pala e ka në shfrytëzim pa afat të caktuar këtë pronë dhe ai është pajtuar për këmbim të pronave në fjalë, shfrytëzuesi i pronës është Xhelal Jonuzi.

Kryesuesi i Kuvendit: Shfrytëzuesi i pronës komunale Xhelal Jonuzi, nuk mund të bëhet pronar i kësaj prone. Nuk mundet komuna pronën e vet komunale me ndërruar me pronë komunale.

z. Qamil Stagova: Kjo pronë është pronë shoqërore, shfrytëzues pa afat të caktuar është Xhelal Jonuzi. Komuna nuk besoj se ka interesim me ia marrë atë pronë.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo pronë është e komunës dhe nuk mundet komuna pronën e vet komunale me ndërruar me pronë komunale. A jeni drejtor i pajtimit që kjo pikë të tërhiqet, në mënyrë që për mbledhjen tjetër të definohet me qartë kjo çështje ?

z. Qamil Stagova: Në rregull, pajtohem të tërhiqet kjo pikë.

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori u pajtua të tërhiqet kjo pikë, a jeni që të tërheqim këtë pikë ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. **Konstatoj se kjo pikë tërhiqet nga rendi i punës.**

7. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit publik të pjesëve të PK 00431-3 dhe 00431-4 në ZK Duraj, për këmbim me pronën komunale 00430-1 ZK Duraj;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Në këtë rrugë trotuar është shtruar 1 vit me herët. Është mirë me i saktësuar çështjet kur të bëhet projekti, e jo me devijuar me vonë projekti.

Kryesuesi i Kuvendit: Projekti ka devijuar me kërkesën e banorëve të komunitetit, për shkak se ka qenë një kthesë aty dhe pasi ka filluar me u ekzekutuar projekti është bërë ky ndryshim. Projektin e kanë bërë qytetarët, edhe ndryshimin e projektit është bërë me kërkesën e tyre, pronarit nuk i bien mirë, por e ka lëshuar për interes të qytetarëve atë pronë.

z. Agim Mani: Unë nuk e di qysh janë bërë marrëveshjet me herët, me shkrim apo me gojë? Ligjërisht marrëveshjet duhet me u bërë me shkrim se jemi institucion.

Kryesuesi i Kuvendit: Interesi është i lagjes e jo i pronarit të pronës.

z. Agim Mani: A ka të drejtë komuna me ra në ndikim të komunitetit, me u devijuar projekti ?

Kryesuesi i Kuvendit: Interesi është me u ndërtuar rruga, përndryshe kur është interesi i komunës, pronën mund t'ia paguaj pronarit. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t'ia adresohet KK për shqyrtim dhe aprovim ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Propozim Vendimin për shpalljen e interesit publik të pjesëve të PK 00431-3 dhe 00431-4 në ZK Duraj, për këmbim me pronën komunale 00430-1 ZK Duraj. Ky Propozim Vendim i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

znj. Ardita Rrahmani: Meqë me 28 Nëntor është 110 vjetori i shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, A e keni menduar me mbajtur një seancë solemne në shënim të kësaj date ?

Kryesuesi i Kuvendit: Ne e kemi menduar këtë çështje, por zakonisht për shënimin e datave historike MAPL po del me njoftim dhe me agjendat për seancat solemne. Kështu ka ndodhur edhe për seancat tjera solemne. Lidhur me shënimin e kësaj feste, nuk kemi ende asnjë njoftim nga MAPL. Nëse MAPL del me një njoftim, meqenëse ne mundem me mbajtur se nuk na pengon askush, e presim njoftimin e MAPL, përndryshe nëse ju e shihni të arsyeshme mundemi me mbajtur një seancë solemne.

znj. Ardita Rrahmani: Unë bisedova me ish anëtarët e KK dhe e kuptova se nuk keni mbajtur seancë solemne në shënim të datës 28 Nëntorit. Meqenëse sivjet është viti jubilar 110 vjetori i shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, mendoj se është e arsyeshme me mbajtur një seancë solemne KK në shënim të kësaj date historike.


Kryesuesi i Kuvendit: Ne kemi mbajtur mbledhje solemne në shënim të datave historike, po e presim agjendën e MAPL, përndryshe nuk e kemi problem me ftuar një seancë solemne, mundem me ftuar 3 ditë përpara.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: E keqja e kësaj është që, festa e 28 Nëntorit- Ditës së Flamurit kombëtar nuk është shënuar festë zyrtare në kalendarin e festave zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit: Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 11:50. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjashtë anëtarët e KPF. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 30 Nëntor 2022 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfite Malsiu

Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

[Signature]